

Qershor 2015

**Shërbimet
Publike Komunale
dhe Ndërmarrjet Publike**

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA

doogapod

SHKURTESAT

KE	Kryeshef Ekzekutiv
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
KRU/KUR	Kompania Rajonale e Ujësjiellit
KK	Kuvendi Komunal
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PPP	Partneritet Publiko-Privat
ZK	Zyra e Kryeministrit
ZRRUK	Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Kanalizimit

Në mënyrë që komunat të marrin nën kontroll investimet e tyre në ujësjellës, Instituti GAP rekomandon që komunave tu jepet në pronësi rrjeti i ujësjellësit.

Përmbledhje ekzekutive

Komunat e Kosovës kanë një numër përgjegjësish ligjore për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarë. Disa nga këto shërbime kryhen me anë të ndërmarrjeve publike (NP) lokale apo rajonale (në pronësi qendrore apo rajonale). **Ofrimi i shërbimeve përmes ndërmarrjeve publike sjellë disa probleme në ndarje të pronësisë (kontrollit) të NP-ve në mes komunave dhe nivelit qendror apo në menaxhimin e NP-ve lokale apo rajonale nga ana e komunave.**

Sa i përket problemeve me nivelin qendror, megjithëse që nga viti 2012 komunave u është lejuar përfaqësimi në bordet e KRU-ve, një pjesë e komunave ende janë të pakënaqura me nivelin e përfaqësimit të interesave të tyre në bordet e KRU-ve. Problem tjetër është edhe fakti se komunat vazhdojnë të investojnë në rrjetin e ujësjellësit, ndërsa pronësinë e këtij rrjeti e merr KRU e cila është në pronësi qendrore. Shumica nga komunat e kanë parë shndërrimin e KRU-ve në pronësi lokale si një model të preferuar të menaxhimit nga ana e tyre. **Në mënyrë që komunat të marrin nën kontroll investimet e tyre në ujësjellës, Instituti GAP rekomandon që komunave tu jepet në pronësi rrjeti i ujësjellësit.**

Problem tjetër në mes komunave dhe nivelit qendror është gjetur të jetë periudha brenda të cilës niveli qendror merr vendim për themelimin e ndërmarrjeve lokale siç është rasti me kërkesën e Komunës së Prishtinës për themelimin e NP-së lokale "Prishtina Parking". Si pasojë e një vendimi për ndryshimin e rregullores për krijimin e NP-ve të reja lokale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka pamundësuar krijimin e NP-së lokale "Prishtina Parking" e cila ka plotësuar kriteret për themelimin që nga Janari 2015.

Sa i përket menaxhimit të NP-ve lokale, shumica e komunave janë shprehur të pakënaqur me kualitetin e dokumenteve dhe sqarimet që jepen në raportet e NP-ve lokale. Gjithashtu komunat duke u ndier të nën përfaqësuar në bordet e KRM-ve, shumica janë shprehur për shndërrimin e KRM-ve nga kompani rajonale të disa komunave në kompani lokale në pronësi të një komune. Sipas tyre, shëndërrimi i KRM-ve në pronësi të komunës do të rriste llogaridhënien e KRM-së ndaj komunës. Së fundmi, si mënyrë e rritjes së cilësisë së mbikëqyrjes së NP-ve lokale, është sugjeruar themelimi i një trupe të specializuar të ngjashme me NJPMNP, e cila do të mbikëqyr bordet e NP-ve lokale.

Përmbajtja

1.	Hyrje	7
2.	Metodologjia	8
3.	Pronësia e KRU-ve dhe përgjegjësitë e komunave për shërbimin e ujit	9
4.	Krijimi i NP-ve lokale dhe koordinimi me nivelin qendror	16
4.1	Rasti i themelimit të NP Parkingu - Komuna e Prishtinës	17
4.2.	Koordinimi në mes nivelit lokal dhe qendror	19
5.	Menaxhimi i ndërmarrjeve lokale	20
5.1	Menaxhimi i KRM-ve	22
6.	Përfundim	23
7.	Rekomandime	24
8.	Anekset	25

1. Hyrje

Komunat janë njësi themelore të qeverisjes lokale në Kosovë. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë një sërë kompetencash në ofrimin e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale që përfshijnë: **“furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal, skemave të ngrohjes lokale; banimin publik, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike”**.¹ Një pjesë të këtyre shërbimeve si menaxhimi i mbeturinave, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike, ngrohja lokale, transporti lokal etj., komunat i menaxhojnë përmes ndërmarrjeve publike lokale, ndërsa furnizimi me ujë bëhet nga ndërmarrjet publike në pronësi qendrore.

Qëllimi i kësaj analize është që të identifikojë problemet që dalin në ofrimin e shërbimeve publike komunale përmes ndërmarrjeve rajonale dhe lokale. Analiza fillimisht trajton problemet e përfaqësimit të komunave në Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit (KRU) dhe preferencat e zyrtarëve komunal lidhur me formën e menaxhimit të KRU-ve. Në vazhdim, kjo analizë trajton çështjet e themelimit të ndërmarrjeve publike lokale si dhe problemet e koordinimit të komunave me nivelin qendror. Pjesa e fundit e analizës trajton problemet me cilësinë e raportimit dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve publike komunale ndaj komunave si dhe kapacitetet e komunave për mbikëqyrje të këtyre ndërmarrjeve.

Disa prej të gjeturave kryesore të kësaj analize tregojnë se me gjithë ndryshimet e bëra në Ligjin për ndërmarrje publike në lidhje me përfshirjen e përfaqësuesve të komunave në bordet e KRU-ve, **një pjesë e komunave ende mbesin të pakënaqura me nivelin e përfaqësimit të interesave të komunës në bordet e këtyre ndërmarrjeve. Për këtë arsye, shumica nga përfaqësuesit e komunave kanë preferuar që KRU-të të shndërrohen në pronësi komunale.**

Megjithëse kriteret për themelimin e NP-ve lokale duket të jenë mjaft të qarta, disa prej komunave kanë vërejtje sa i përket periudhës brenda të cilës niveli qendror ofron përgjigje për themelimin e këtyre ndërmarrjeve. Sa i përket menaxhimit të NP-ve lokale, shumica e komunave janë shprehur të pakënaqur me kualitetin e dokumenteve dhe sqarimet që jepen në raportet e NP-ve lokale nga ndërmarrjet publike lokale. Shumica nga komunat, si mënyrë e rritjes së cilësisë së mbikëqyrjes së NP-ve lokale, kanë sugjeruar themelimin e një trupe të specializuar të ngjashme me NJPMNP, e cila do të mbikëqyre bordet e NP-ve lokale.

¹ Ligji Nr.03/ L-040 për Vetëqeverisje lokale, 04 Qershor 2008, Burimi: <http://bit.ly/1EYKuWq>

2. Metodologjia

Kjo analizë përdor burime primare dhe sekondare të të dhënave si bazë për identifikimin e problemeve të ndërmarrjeve publike. Të dhënat primare për identifikimin e problemeve kryesore janë mbledhur duke realizuar intervista dhe zhvilluar një pyetësor me drejtorët e shërbimeve publike të komunave të Kosovës.

Pyetësorët për zyrtarët e ndërmarrjeve kanë qenë të standardizuar. Përveç pyetjeve të hapura, pyetësi përfshin pohime ku pastaj zyrtarët kanë mund të zgjedhin nga shkalla një deri në pesë nëse ata pajtohen me pohimet. Gjithsej janë intervistuar 19 drejtorë të shërbimeve komunale. Pyetjet përfshijnë tema si koordinimi dhe përgjegjësitë më kompanitë rajonale të ujësjellësit (KRU), krijimi i ndërmarrjeve publike lokale dhe koordinimi me nivel qendror dhe çështjet e menaxhimit të NP-ve lokale.

Burimet sekondare të përdorura në këtë punim përfshijnë Ligjin nr. 03/L-87 për NP-të, raportet vjetore të NP-ve, raportet vjetore të NJPMNP-së, raportet e rregullatorëve etj.

3. Pronësia e KRU-ve dhe përgjegjësitë e komunave për shërbimin e ujit

Në Kosovë funksionojnë shtatë kompani rajonale të ujësjellësit dhe kanalizimit (KRU) të cilat ofrojnë shërbime për komuna apo rajone të ndryshme të Kosovës.² Në bazë të pronësisë, **gjashhtë nga shtatë KRU-të janë në pronësi të Qeverisë së Kosovës, ndërsa vetëm KRU Bifurkacioni është në pronësi lokale (Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Kaçanikut).**

Në përputhje me Nenin 5.1 të Ligjit për NP, Qeveria ka të drejtë ekskluzive për menaxhimin e ndërmarrjeve publike pronësia e të cilave i përket nivelit qendror.³ Sipas Nenit 8.1 të po këtij ligji, Qeveria i raporton vetëm Kuvendit të Kosovës për performancën e këtyre ndërmarrjeve. Ndërsa në bazë të Nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, ndër të tjera komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive sa i përket furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të zeza.⁴

Deri në vitin 2012, bordet e KRU-ve janë zgjedhur me procedurë të njëjtë sikurse të gjitha ndërmarrjet tjera qendrore, që do të thotë se të gjithë anëtarët e bordeve janë zgjedhur nga Qeveria e Kosovës. Në bazë të një hulumtimi të kryer në vitin 2011, në mënyrë që të balancoheshin nevojat e komunave për përfaqësim në KRU, ishte rekomanduar që të bëheshin ndryshime në Ligjin për NP.⁵ Një vit pas dhënies së këtyre rekomandimeve, ishte ndryshuar Ligji për NP-të, dhe sipas këtij ndryshimi deri gjysma e anëtarëve të bordeve të KRU-ve duhet të emërohen nga kandidatë të propozuar nga komunat.⁶

² Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturisë Ibri dhe Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturisë 24 Nëntori janë në pronësi lokale të komunës së Zubin Potokut përkatësisht Leposaviqit

³ Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, 15 Qershor 2008, Burimi: <http://bit.ly/1vs647w>

⁴ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 17, 4 Qershor 2008, Burimi: <http://bit.ly/1CulaKA>

⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit dhe Zyra Zvicerane e Bashkëpunimit në Kosovë, Roli i Komunave në Shërbimet e Ujësjellësit në Kosovë, Qershor 2011, Burimi: <http://bit.ly/1JIGbm>


⁶ Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, 30 Maj 2012, Burimi: <http://bit.ly/1F558Gd>

Procedura e zgjedhjes së drejtorëve të bordeve të KRU-ve nga komunat

Procedura e nominimit dhe zgjedhjes së kandidatëve për drejtorë të bordeve të KRU-ve nga komunat përcaktohet me akt nënligjor. Në bazë të udhëzimit administrativë për pjesëmarrjen e komunave në borde të ndërmarrjeve rajonale të ujit, bordi i KRU-ve përbëhet nga gjashtë anëtarë joekzekutiv dhe kryeshefi ekzekutiv. Fillimisht, komunat nominojnë të paktën tre kandidatë më tepër se pozitat e rezervuara për drejtorë të komunave. Më pas, Komisioni Rekomandues (niveli qendror) bën një vlerësim nëse kandidatët i plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuar në Ligjin për NP. Në fund, komunat bëjnë nominimin e tre kandidatëve kryesor (përfshirë kandidatin për komunitete pakicë) dhe tre kandidatëve rezerve për anëtarë të bordeve përmes Asociacionit të Komunave.

Renditja të nominuarve nga komunat me prioritet bëhet varësisht nga numri i konsumatorëve. Në anën tjetër, megjithëse komunat kanë të drejtë nominimi për drejtorë të bordeve, të drejtën për mbikëqyrjen dhe shkarkimin e anëtareve të bordeve (përfshirë atyre të kandiduar nga komunat) të KRU-ve ka vetëm Qeveria pas rekomandimit të NJPMNP.

Megjithë ndryshimet e bëra në Ligjin për NP, në bazë të përgjigjeve të drejtorëve të shërbimeve publike, opinioni i tyre është pothuajse i ndarë në gjysmë sa i përket UA për përfaqësim të komunave në bordet e KRU-ve, ku rreth 47% e të të intervistuarve mendojnë se UA për përfaqësim të komunave në bordet e KRU-ve u siguron përfaqësim të mjaftueshëm të interesit të komunave në KRU, ndërsa rreth 50% e të intervistuarve mendojnë se interesat e tyre nuk përfaqësohen mjaftueshëm në KRU. Rreth 50% prej tyre mendojnë se ky model do të duhej të ndryshohej. Në vazhdim, 40% të të intervistuarve nuk pajtohen plotësisht apo pjesërisht me pohimin se objektivat e KRU-ve përcillen qartë tek komunat, ndërsa një përqindje më e madhe rreth 50% prej tyre pajtohen me këtë pohim.



Komunat dhe Bordet e KRU-ve




Figura 1. Përfaqësimi i komunave në bordet e KRU-ve

Siç u cek më lartë, duke qenë se Ligji për Vetëqeverisje Lokale i bën komunat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të ujit, shumë nga komunat vazhdojnë të investojnë në ujësjellës dhe pastaj rrjetin ia dorëzojnë kompanisë rajonale të ujësjellësit (në të cilën nuk janë aksionarë). Në bazë të dhënave të nxjerrangaraportet financiare të komunave dhe Ligjit për Buxhetin e Kosovës, **vetëm në periudhën 2010-2015 janë investuar apo planifikohet të investohen së paku 9.2 milionë euro në rrjetin e ujësjellësit nga ana e komunave.**

Investimet në ujësjellës nga komunat




Figura 2. Investimet në rrjetin e ujësjellësit nga komunat

Në përpjekje për të gjetur modelin e preferuar nga komunat lidhur me formën e menaxhimit të KRU-ve, pyetjet në vazhdim kanë të bëjnë lidhur me pronësinë e KRU-ve.

Rreth 80% e të intervistuarve janë shprehur se KRU-të do të duhej të ishin në pronësi të komunës/komunave. Sa i përket formës së pronësisë, rreth 52% janë shprehur se janë kundër privatizimit ndërsa rreth 32% prej tyre nuk kanë opinion. Edhe sa i përket privatizimit të pjesshëm të KRU-ve, rreth 65% nuk e përkrahin një ide të tillë apo nuk kanë qëndrim.

Sa i përket efekteve të konkurrencës në sektor, rreth 52% të intervistuarve mendojnë se do ta rriste kualitetin e shërbimeve dhe do të ulte tarifat e shërbimeve, ndërsa rreth 40% prej tyre nuk pajtohen ose nuk kanë qëndrim se konkurrenca do të kishte efektet e lartpërmendura. Sa i përket partneritetit publiko-privat, opinioni është i ndarë në mënyrë të barabartë ku rreth 37% mendojnë se do të ishte formë e përshtatshme e menaxhimit ndërsa e njëjta përqindje mendojnë të kundërtën, kurse pjesa tjetër nuk kanë qëndrim.

Vetëm në periudhën 2010-2015 janë investuar apo planifikohet të investohen së paku 9.2 milionë euro në rrjetin e ujësjellësit nga ana e komunave.

Pronësia e KRU-ve



Figura 3. Pronësia dhe efektet e konkurrencës tek KRU

Në pyetjen nëse bashkimi me një ndërmarrje tjetër do të rriste efikasitetin e ndërmarrjes, 47.4% e të intervistuarve pajtohen me këtë, ndërsa rreth 47% e tyre nuk kanë një qëndrim të caktuar për këtë çështje.

Në bazë të mesatareve për vitin 2012-2013, madhësia e KRU-ve e matur me volumin e shitjeve nuk duket të

Kompania Rajonale e Ujësjetjesit	Volumi i shitjeve (m3)	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar (euro/m3)
KRU Prishtina (Prishtinë)	20,696,326	0.052
KRU Hidrodrini (Pejë)	8,571,958	0.004
KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)	7,711,897	0.072
KRU Radoniqi (Gjakovë)	6,688,086	0.023
KRU Mitrovica (Mitrovicë)	4,333,025	0.050
KRU Hidromorava (Gjilan)	3,206,004	0.054
KRU Bifurkacioni (Ferizaj)	2,632,643	0.043

Tabela. 1. Efekti i madhësisë së KRU-së në efikasitet

Burimi: Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Kanalizimit (ZRRUK)

ketë ndonjë efekt në kosto për njësi të ujit të prodhuar.

4. Krijimi i NP-ve lokale dhe koordinimi me nivelin qendror

Megjithëse në bazë të nenit 11.3 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për NP, komunat kanë të drejtë krijimin e NP-ve lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me aktet nën-ligjore të Qeverisë. Neni 11.1 i Ligjit për NP specifikon se një ndërmarrje publike mund të krijohet vetëm nëse autorizohet me një vendim nga Qeveria. Përgjegjës për krijimin dhe drejtimin e NP-së, janë komisioni komunal i aksionarëve, Bordi dhe menaxhmenti i NP-së.

Kriteret për themelimin e një ndërmarrje lokale ndër të tjera përfshijnë:

- a) paraqitjen e një raporti dhe garancioni nga komunat lidhur me qëndrueshmërinë financiare dhe operative në NJPMNP;
- b) përpilimin e planit të biznesit dhe planin e buxhetit;
- c) sigurimin e hapësirës punuese dhe pajisjet teknike për funksionim normal dhe ofrimin e shërbimeve nga themeluesi; dhe
- d) caktimin e selisë së NP-së brenda territorit të komunës (disa komunave të cilat e kanë regjistruar ndërmarrjen).

Shqyrtimi i kërkesës për krijimin NP-ve nga NJPMNP duhet të bëhet brenda 30 ditëve të pranimit

të kërkesës nga komunat, dhe pastaj këtë kërkesë NJPMNP e përcjell tek Komisioni Ministror për Ndërmarrjet Publike. Në rast se janë plotësuar kriteret, Komisioni rekomandon Qeverisë krijimin e NP-së.

NJPMNP, që nga viti 2013, ka pranuar kërkesa nga tetë komuna për krijimin e ndërmarrjeve të reja.⁷ Deri më tani ka shqyrtuar gjashtë kërkesa nga të cilat dy janë refuzuar, ndërsa katër kërkesa janë ende në shqyrtim.⁸ Sipas NJPMNP, dy komunave u janë refuzuar kërkesat ngase është dashur të ruhet sistemi regjional i funksionimit të ujësjellësit në përputhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për konsolidimin e ujërave.⁹ Në bazë të intervistave të realizuara me drejtorët e shërbimeve publike komunale nga nëntë komunat që kanë aplikuar për krijimin e ndërmarrjeve të reja, shtatë prej tyre pajtohen ose pajtohen pjesërisht se kriteret për krijimin e NP-ve publike janë të qarta, ndërsa vetëm 2 nuk janë pajtuar me këtë pohim. Në përgjithësi, megjithë besimin se kriteret për krijimin e NP-ve të reja janë të qarta, rreth 37% e të intervistuarve besojnë se ka nevojë për ndryshim të kriterëve. Mirëpo, në pyetjen se çfarë duhet të ndryshohet, kryesisht kritikën apo ankesat kanë qenë sa i përket respektimit të afateve dhe refuzimit të kërkesave në përgjigje për krijimin e NP-ve të reja nga niveli qendror.

⁷ Shih Aneksin 2 lidhur me listën e komunave të cilat kanë aplikuar për krijimin e NP-ve të reja lokale

⁸ Janë refuzuar Deçani dhe Kaçaniku, ndërsa Gjilan, Ferizaj, Prizren dhe Prishtinë janë në shqyrtim


⁹ Qeveria e Kosovës, Vendimi Nr. 06/18, 08 Qershor 2011, Qasur me 16 Mars 2015, Burimi: <http://bit.ly/1GLApy8>

4.1 Rasti i themelimit të NP Parkingu - Komuna e Prishtinës

Me 29 Shtator 2014, Kuvendi Komunal i Komunës së Prishtinës mori vendim për të filluar procedurat e themelimit të NP "Prishtina Parking". Fillimisht ligjshmëria e këtij vendimi ishte kontestuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).¹⁰ Pas ndryshimeve të vendimit nga ana e Komunës së Prishtinës, me 8 Dhjetor 2015, kërkesa e Komunës së Prishtinës së bashku me raportin mbi qëndrueshmërinë financiare dhe operative të ndërmarrjes ishte proceduar në NJPMNP.

Pas një muaji (8 Janar 2015), kjo e fundit i është drejtuar Komunës së Prishtinës me një kërkesë për dokumente shtesë dhe me datë 28 Janar 2015 i ka dërguar një njoftim lidhur me kërkesën e Komunës së Prishtinës.¹¹ Në këtë njoftim, Komuna e Prishtinës informohet nga NJPMNP se Komuna ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas rregullores për krijimin e ndërmarrjeve lokale, dhe se Komisioni i Ministrave për NP është duke e shqyrtuar konkluzionin e NJPMNP dhe do të vendos mbi statusin e kërkesës.¹²

Ndonëse komuna ka një aprovim me shkrim se kanë plotësuar kriteret për themelimin e NP-ve lokale, komuna nuk ka mundur ende të themelojë ndërmarrjen publike e cila i garantohet me Ligjin për NP. Arsye për mbetjen pezull të themelimit të NP "Prishtina Parking", është vendimi i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik (MZHE) i datës 24 Janar 2015, me anë të cilit pezullohet themelimi i NP-ve lokale nën arsyetimin se duhet të themelohet një grup punues për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për themelimin e NP-ve e cila përcakton kriteret për themelimin e NP-ve lokale. Në bazë të përgjigjeve të NJPMNP, rregullorja do të plotësohet me kriteret lidhur me nevojat sektoriale për themelimin e NP-ve lokale¹³.



Mbledhja e mbeturinave në Komunën e Kamenicës

Që nga data 1 gusht 2012, Komuna e Kamenicës, **pa themeluar ndonjë ndërmarrje publike lokale, ka filluar mbledhjen e mbeturinave dhe inkasimin e të hyrave në llogarinë e komunës.** Duke qenë se mbledhja e mbeturinave është kryer nga komuna, ky aktivitet është kryer pa marrë ndonjë licence nga MZHE dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Gjatë kësaj kohe, punëtorët nuk kanë qenë të regjistruar dhe pagat e punëtorëve janë financuar nga buxheti i komunës. **Gjatë dy viteve kompania ka grumbulluar rreth 50 mijë euro fitim.** Sipas Drejtorit të Shërbimeve Publike, arsyeja pse nuk është licencuar ndërmarrja ka qenë pamundësia për të arritur një memorandum mirëkuptimi mes tri komunave Kamenicë-Gjilan-Viti, të cilat kanë pasur në pronësi ndërmarrjen rajonale të mbeturinave, e nga e cila është krijuar edhe ndërmarrja në Kamenicë.

¹⁰ KOHA.net, MAPL-ja s'e lë Komunën e Prishtinës ta themelojë NP "Prishtina Parking", Burimi: <http://bit.ly/1Phb6g2>

¹¹ Dardan Sejdiu- Nënkyetar i Komunës së Prishtinës, Përgjigje me email drejtuar Institutit GAP, 26 Shkurt 2015

¹² Shih Aneksin 2


¹³ Ramadan Sejdiu-Udhëheqës i NJPMNP, Bisedë telefonike, 19 Shkurt 2015

	Komunat	% e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	% e pagesave të bëra	% e qytetarëve që janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave
2012	Mesatarja për të gjitha komunat	57.98%	60.83%	54.33%	47.89%
	Kamenicë	26.40%	12.07%	58.25%	49.00%
2013	Mesatarja për të gjitha komunat	60.99%	64.19%	62.12%	-
	Kamenicë	34.90%	12.07%	53.80%	-

Tabela 2. Idikatorë të performancës në sektorin e mbeturinave për K. e Kamenicës

Ndërmarrja ka funksionuar si e tillë deri në Qershor të vitit 2014 kur hyn në fuqi një marrëveshje e nënshkruar nga Kuvendi Komunal (KK) i Komunës së Kamenicës dhe KRM "Eco-Higjiena" sh.p.k për integrimin e Njesisë së Kamenicës në Kompaninë Eco-Higjiena. Në vendimin e KK të K. Kamenicës ndër tjera precizohet se:

- a) 23 punëtorët e kësaj ndërmarrje kalojnë në kompaninë Eco-Higjiena dhe mbesin në pozitat ekzistuese, si dhe marrin paga të paktën sa ato që kanë marrë nga K. e Kamenicës;
- b) asetet fikse (përveç tregut të gjelbër të Kamenicës) dhe të gjitha të arkëtueshmet e klientëve do të bar-ten nga njësia e KRM-së në Kamenicë tek "Eco-Higjiena" sh.p.k;
- c) të gjitha shpenzimet, tarifat dhe detyrimet e shkaktuara gjatë periudhës së funksionimit të kësaj ndër-marrje mbesin në Komunën e Kamenicës;
- d) Komuna e Kamenicës të paktën do të jetë e ftuar në mbledhjen e bordeve si mysafir me të drejtë të plotë të informimit dhe shprehjes së mendimit, mirëpo pa të drejtë vote dhe kompensimi për pjesëmarrjen në takim.



4.2 Koordinimi në mes nivelit lokal dhe qendror


Përveç problemeve lidhur me krijimin e NP-ve të reja lokale, rreth 47% të intervistuarve mendojnë se gjatë ndarjes së subvencioneve nga niveli qendror ka ndikim politik, ndërsa rreth 31% prej tyre kanë një qëndrim neutral sa i përket këtij pohimi. Afër 80% e të intervistuarve mendojnë se koordinimi jo i mirë në mes të institucioneve qendrore dhe lokale është pengesë në menaxhimin e ndërmarrjeve publike lokale, ndërsa bashkëpunimin me nivelin qendror 26% prej tyre e vlerësojnë si të mirë dhe po aq e vlerësojnë si të dobët, derisa pjesa tjetër ka një qëndrim neutral ndaj kësaj çështje. Rreth 84% e të intervistuarve pajtohen se legjislacioni primar rregullon mjaftueshëm funksionimin e NP-ve dhe afër 42% mendojnë se legjislacioni ka nevojë për plotësim ndryshime. Sa i përket legjislacionit sekondar, 62% pajtohen se udhëzimet administrative rregullojnë mjaftueshëm sektorin, ndërsa rreth 58% e të intervistuarve mendojnë se avokimi tek institucionet qendrore është i vështirë. Përveç problemeve me koordinim me nivelin qendror, në bazë të përgjigjeve të të intervistuarve, vetëm 39% pajtohen se koordinimi me komunat tjera është mjaft i mirë, ndërsa rreth 30% e tyre pajtohen pjesërisht me këtë pohim.

5. Menaxhimi i ndërmarrjeve lokale

Në bazë të Nenit 31.2 të Ligjit për NP, brenda 3 muajve pas përfundimit të vitit kalendarik, Bordi i Drejtorëve i një NP-je lokale duhet t'i dorëzojë Komisionit Komunal të Aksionarëve një raport vjetor për vitin kalendarik dhe rezultatet e arritura në bazë të caqeve të vendosura në Planin e Biznesit. Përveç raportimit të rregullt, Bordi duhet të i përgjigjet menjëherë të gjitha kërkesave për informata që kërkohen nga Komisioni Komunal i Aksionarëve. Në bazë të përgjigjeve të të intervistuarve, shumica (58%) janë të kënaqur me nivelin e shpjegimeve të dhëna në raportin vjetor, mirëpo një përqindje më e ulët (37%) janë të kënaqur me shpjegimet e dhëna në raportet financiare. Është interesant të theksohet se K. e Prishtinës, si komuna me numrin më të madh të ndërmarrjeve lokale, në të dyja rastet është shumë e pakënaqur me sqarimet që jepen në këto dy dokumente. Gjithashtu, disa komuna më të vogla nuk kishin pranuar fare raporte financiare nga kompanitë përkatëse lokale/rajonale.¹⁴ Në pyetjen tonë nëse komunat i publikojnë këto dokumente në ueb-faqe, 63% e komunave kanë deklaruar se nuk e bëjnë një gjë të tillë.

¹⁴ Drenas, Fushë-Kosova, Obiliqi, Suharekë

Raportimi i NP-ve lokale



Në bazë të Nenit 7.1, aksionari (në këtë rast komuna) mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme punën e Bordit të Drejtorëve. Për dallim nga niveli qendror ku NJPMNP bën një vlerësim formal të punës së të gjitha NP-ve qendrore, në nivel lokal në mungesë të një departamenti të tillë, mbikëqyrja e punës së bordeve bëhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve. Në bazë të përgjigjeve, 42% e komunave nuk bënin ndonjë vlerësim formal për punën e bordeve. Është interesant të theksohet se megjithëse 74% e të intervistuarve mendojnë se komuna ka kapacitete për mbikëqyrjen e bordeve, 63% mendojnë se është e nevojshme krijimi i një trupe profesionale e cila mbikëqyr punën e bordeve dhe shumica mendojnë se kjo trupë duhet të financohet nga komunat.

Vlerësimi i bordeve të NP-ve lokale





Figura 5. Vlerësimi i bordeve të NP-ve lokale



5.1 Menaxhimi i KRM-ve

Sa i përket menaxhimit të KRM-ve. 90% e të intervistuarve mendojnë që ato do të duhej të shndërrohen nga ndërmarrje rajonale, të cilat janë në pronësi të disa komunave, në ndërmarrje lokale të vetëm një komune. Arsye më e shpeshtë për këtë është cekur mundësia për rritje të llogaridhënies së ndërmarrjes dhe gjithashtu mundësia më e mirë e kontrollit të investimeve apo subvencioneve nga ana e komunës për ndërmarrjen. Arsyeje tjetër mund të jetë edhe pamundësia e përfaqësimit të interesave të komunave në këto ndërmarrje, ngase rreth 37% prej të intervistuarve kanë deklaruar se UA nuk u siguron përfaqësim të mjaftueshëm në bordet e NP-ve lokale.¹⁵

Sa i përket formës së pronësisë, shumica prej tyre (53%) mendojnë se ndërmarrjet nuk do të duhej të privatizoheshin, ndërsa vetëm 26% janë për privatizimin e tyre, kurse pjesa tjetër nuk kanë ndonjë qëndrim. Një përqindje më e lartë apo 42% e të intervistuarve janë shprehur në favor të partneritetit publiko-privat, ndërsa 32% prej tyre janë kundër kësaj forme të menaxhimit.

Lidhur me pohimin nëse një operator privat kishte me qenë më efektiv në menaxhimin e mbeturinave, rreth 53% të intervistuarve pajtohen plotësisht ose pjesërisht, ndërsa 40% prej tyre nuk pajtohen me këtë pohim. Sa i përket pohimi se në sektor ka konkurrencë të mirëfilltë, rreth 74% nuk pajtohen me një pohim të tillë. Në një studim të publikuar nga Instituti GAP është gjetur se problem kryesor i KRM-ve sa i përket konkurrencës është shfrytëzimi i deponimeve të egra nga kompanitë private të mbledhjes së mbeturinave.¹⁶

Duke u kthyer tek përgjigjet e të intervistuarve, 84% prej tyre besojnë se konkurrenca do të rriste cilësinë

¹⁵ Udhëzim Administrativ për mënyrën e përfaqësimit të komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike lokale, Burimi: <http://bit.ly/10AIZ4v>

¹⁶ Instituti GAP, Ndërmarrjet Publike-Legjislativi dhe Bashkëpunimi me Institucionet Zyrtare, 27 Janar 2015, Burimi: <http://bit.ly/1A5kZ9B>

e shërbimeve ndërsa sa i përket efektit në uljen e tarifave 47% prej tyre mendojnë se kjo nuk do të kishte ndonjë efekt, ndërsa 42% mendojnë të kundërtën. Në fund, 74% e të intervistuarve mendojnë se tarifat janë në përputhje me koston e ofrimit të tyre, 16% mendojnë se janë të ulëta, ndërsa 10% mendojnë se janë larta.

Eco-Higjiena- Kompania e vetme për menaxhimin e mbeturinave me partneritet publiko-privat (PPP)

Eco-Higjiena është kompania e parë edhe e vetme në Kosovë në fushën e pastrimit, e cila është themeluar sipas Marrëveshjes së Partneritetit Publiko-Privat (PPP) dhe kryen shërbimet e pastrimit në territorin e Regjionit të Gjilanit.

Eco-Higjiena sh.p.k., me seli në Gjilan, është e themeluar më datën 23 maj 2012, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa veprimtarinë e saj e ka filluar më datë 1 Korrik të vitit 2013.

Eco-Higjiena ka të punësuar 141 punëtorë, ndërsa para se të privatizohej kishte të punësuar rreth 137 persona. Duke marrë parasysh se në shifrën prej 141 punëtorëve nuk përfshihet dega e Kamenicës, atëherë shihet një rritje e dukshme sa i përket numrit të punësuarve në këtë kompani.

Sipas stafit të kësaj kompanie, kënaqshmëria e konsumatoreve rreth shërbimeve të kësaj ndërmarrje është në rritje pas hyrjes së PPP-së si pasojë e rritjes së efikasitetit në punë dhe disiplinës në ofrimin të shërbimeve. **Përveç kësaj, kompania ka investuar në pa-jisje operative për ofrim të shërbimeve më cilësore dhe ka pasur rritje të stafit në të gjithë sektorët. Si pasojë janë zvogëluar ankesat e konsumatoreve dhe pas hyrjes së PPP-së janë rritur arkëtimet për 40%.**

6. Përfundim


Në këtë analizë është diskutuar lidhur me çështjet e menaxhimit të shërbimeve komunale dhe problemet që dalin në koordinim me KRU-të, ndërmarrjet lokale dhe nivelin qendror.

Në bazë të intervistave me drejtorë të shërbimeve publike komunale del se megjithë përfshirjen e përfaqësuesve të komunave në bordet e KRU-ve, një pjesë e komunave ende janë të pakënaqur me nivelin e përfaqësimit të interesave të tyre në bordet e KRU-ve. Problem tjetër është edhe fakti se komunat vazhdojnë të investojnë në rrjetin e ujësjellësit, ndërsa pronësinë e këtij rrjeti e merr KRU e cila është në pronësi qendrore. Shumica nga komunat e kanë parë shndërrimin e KRU-ve në pronësi lokale si një model të preferuar të menaxhimit nga ana e tyre.

Në anën tjetër, megjithëse kriteret dhe procesi i themelimit të ndërmarrjeve lokale janë mjaft të qarta, në praktikë themelimi i ndërmarrjeve loka

le ka pasur mjaft probleme. Problemi më i madh është identifikuar sa i përket pritjes së gjatë të kërkesave të komunave në nivelin qendror, siç është rasti me kërkesën e Komunës së Prishtinës për themelimin e ndërmarrjes lokale "Prishtina Parking". Përveç problemeve me nivelin qendror, sipas drejtorëve të NP-ve probleme ka edhe sa i përket koordinimit dhe komunikimit me komunat tjera lidhur me çështjet e menaxhimit të NP-ve.

Sa i përket menaxhimit të ndërmarrjeve lokale nga komunat, si çështje më problematike mund të theksohet mungesa e personelit të specializuar për mbikëqyrjen e bordeve lokale. Gjithashtu komunat duke u ndier të nën përfaqësuar në bordet e KRM-ve, shumica janë shprehur për shndërrimin e KRM-ve nga kompani rajonale të disa komunave në kompani lokale në pronësi të një komune.



7. Rekomandime

Duke marrë parasysh këto të gjetura, Instituti GAP rekomandon:

- 1.** Si mënyrë për të rritur incentivat për investim në rrjetin e ujësjellësit nga komunat, komunave tu jepet në pronësi rrjeti i ujësjellësit ose përqindje e aksioneve në KRU në bazë të vlerës të investimit në ujësjellës;
- 2.** Në mungesë të kapaciteteve për mbikëqyrje të punës së bordeve të NP-ve lokale nga NJPMNP, komunat të krijojnë një trup të ngjashme e cila do të specializohet në mbikëqyrjen e punës së bordeve;
- 3.** Rregullorja për krijimin e NP-ve lokale duhet të precizojë nëse komunat kanë nevojë për shqyrtim të ligjshmërisë së kërkesës në rastin e themelimit të NP-ve lokale;
- 4.** Përcaktimi i sektorëve me interes për themelimin e ndërmarrjeve lokale të bëhet me anë të një strategjie e jo të përfshihet në rregulloren për kriteret e themelimit të NP-ve lokale;
- 5.** Rregullorja për krijimin e NP-ve lokale duhet të precizojë afatin kohorë brenda të cilit Komisioni Ministror për Ndërmarrjet Publike duhet të shqyrtojë kërkesat e komunave për themelimin e NP-ve;
- 6.** Qeveria dhe Komunitat duhet të kujdesen që të krijojnë kushte të konkurrencës së barabartë në mes kompanive që ofrojnë grumbullimin e mbeturinave;
- 7.** Qeveria e Kosovës dhe komunat të bëjnë analiza lidhur me koston dhe përfitimet e futjes së partneritetit publiko privat në menaxhimin e KRM-ve;
- 8.** Ndërmarrjet publike lokale të rrisin kualitetin e raporteve dhe sqarimeve në raportet të cilat duhet t'i nxjerrin në bazë të ligjit për NP;
- 9.** Në mungesë të ueb-faqeve zyrtare të disa ndërmarrjeve publike lokale, si mënyrë për të rritur transparencën ndaj publikut, komunat të fillojnë të publikojnë dokumentet e ndërmarrjeve lokale në të cilat janë aksionare.

8. ANEKSET

Tabela. 1 . Lista e të intervistuarve

Institucioni	Emri i të intervistuarit	Data e intervistës
Komuna e Prizrenit	Hasan Hasani	01.08.2014
Komuna e Suharekës	Nexhat Ramadani	01.08.2014
Komuna e Malishevës	Milazim Morina	03.08.2014
Komuna e Rahovecit	Feim Fetoshi	01.08.2014
Komuna e Dragashit	Tafil Krasniqi	31.07.2014
Komuna e Obiliqit	Burim Gërguri	08.08.2014
Komuna e Podujevës	Faik Muqiqi	11.08.2014
Komuna e Drenasit	Hyrije Thaqi	12.08.2014
Komuna e Fushë Kosovës	Maliq Berisha	15.08.2014
Komuna e Lipjanit	Heset Sahiti	15.08.2014
Komuna e Kaçanikut	Shkelqim Jakupi	20.08.2014
Komuna e Ferizajt	Fatmir Azizi	20.08.2014
Komuna e Deçanit	Izet Zenuni	28.08.2014
Komuna e Pejës	Ukë Selimaj	28.08.2014
Komuna e Istog	Bedri Hasanaj	29.08.2014
Komuna e Klinës	Gjok Lleshaj	29.08.2014
Komuna e Kamenicës	Faton Jakupi	02.09.2014
Komuna e Gjakovës	Burim Meqa	05.09.2014
Komuna e Prishtinës	Ardian Gashi	06.02.2015

Aneks 2

Lista e komunave me kërkesa për krijimin e NP-ve të reja dhe fusha e veprimit të tyre

KOMUNA	FUSHA E VEPRIMIT TË NP-SË
Deçani	Furnizimit me ujë të pijshëm
Kaçaniku	Furnizimit me ujë të pijshëm
Gjilani	Menaxhim të tregut, parqeve dhe parkingjeve
Ferizaj	Menaxhimi të varrezave, shesheve, parqeve dhe parkingjeve
Prizreni	Grumbullim të mbeturinave
Prishtina	Menaxhimi të parkingjeve
Graçanica	Menaxhim të tregut, mbeturinave, furnizimit me ujë etj.
Hani i Elezit	Grumbullim të mbeturinave

Aneks 3



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministry of Economic Development			
Numri i Dokumentit / Doc. No.	01/3	Numri i Projesit / Proj. No.	203
Numri i Dokumentit / Doc. No.	1	Data e Miratimit / Date	28.01.2015
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

NJËSIA PËR POLITIKA DHE MONITORIM TË NDERMARRJEVE PUBLIKE

DATE/A:	28.01.2015
REFERENC-Ë:	01-28
PËRZA/TO:	z. Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës
KOPJE/KOPIJA/COPY	z. Blerand Stavileci, Ministër i MZHE-së;
NGA/OD/FROM:	Ramadan Sejdiu-drejtor i NJPMNP-MZHE 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim mbi shqyrtimin e Kërkesës suaj nr. 01-31/277434

I nderuari z. Ahmeti,

Duke ju uruar pune te mbare ne kryerjen e misionit tuaj besuar nga qytetaret e Komunës se Prishtinës, shfrytëzoi rastin që të ju informoi së mbështetur në Rregulloren Nr. 03/113 mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrjes së Komunave në bordet e kompanive rajonale te ujit, dhe ne përputhje me afatin ligjor ,NJPMNP ka shqyrtuar kërkesën tuaj pas plotësimit te kërkuar nga NJPMNP, dhe pas analizimit ka sjell Konkluzionin për Komisionin e Ministrave për NP, se kërkesa e juaj i përmbush kriteret e përcaktuara nga rregullorja e lartpërmendur.

Komisioni i Ministrave mbi NP, është duke e shqyrtuar Konkluzionin e NJPMNP dhe do te vendos mbi statusin e kërkesës suaj ne përputhje me e politikat qeveritare .

Faleminderit në mirëkuptim.

Me respekt,



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të
Avancuara GAP përkrahet nga:



Kjo analizë është përkrahur nga:



British Embassy
Pristina

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahje nga Ambasada Britaneze në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura këtu janë përgjegjësi e Institutit GAP dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë qëndrimet e donatorëve.